

## Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

### Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 11-17.11.2024

Janë testuar gjithsej 194 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=187) është shënuar një rritje prej 3,7%.

Pozitive janë 2 raste, 2 më pak nga java e kaluar. Përqindja e rasteve pozitive sillet nga 0,0% deri më 2,6%, mesatarisht 0,7%.

**Tabela 1.** Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 11-17.11.2024

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
11.11.2024	39	1	2,6%
12.11.2024	35	0	0,0%
13.11.2024	39	1	2,6%
14.11.2024	19	0	0,0%
15.11.2024	35	0	0,0%
16.11.2024	17	0	0,0%
17.11.2024	10	0	0,0%
Gjithsej	194	2	mesatarja 0,7%

Gjatë javës së kaluar raste janë regjistruar në Shkup.

Raste të reja janë regjistruar tek grupmosha mbi 30 vjet.

Sipas algoritmit të ri, si të shëruar konsiderohen 3 persona që kanë qenë të shtruar në spital ose në trajtim shtëpiak.

Gjatë javës së kaluar (11-17.11.2024), nuk është raportuar rast i vdekjes si pasojë e COVID-19.

### GJENDJA KUMULATIVE ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Gjatë vitit 2024, deri më 17.11.2024, janë regjistruar gjithsej 1.739 raste me COVID-19. Në muajin tetor të vitit 2024 (56) regjistrohet një rënie prej 80,6% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2024, deri më 17.11.2024, janë testuar gjithsej 12.586 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

### VLERËSIMI I RREZIKUT

Pas një periudhe aktiviteti shumë të ulët, detektohet një rritje e aktivitetit të SARS-CoV-2 brenda kontinentit evropian, përfshirë edhe në R. e Maqedonisë së Veriut.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

### Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).<sup>1</sup>

Shkup, 18.11.2024

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

---

<sup>1</sup> <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>